VENDIM
Nr. 899, datë 17.12.2014

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. LULZIM BREGAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Lulzim Bregaj, në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama